

webermur LM 13

Llaç Suvatimi

■ Përshkrimi

webermur LM 13 është një llaç i thatë, i përbërë nga gëlqere e hidratuar, çimento Portland gri, inerte të zgjedhura dhe aditivë kimikë që përmirësojnë punueshmërinë dhe ngjitjen në tulla të llojeve të ndryshme.

■ Avantazhet

- Ngjithshmëri shumë të mirë në bazament
- Përgatitet lehtësisht
- Aplikim manual ose me pompë

■ Përdorimi

- Materiali përdoret si dorë e parë për suvatim në ambiente të brendshme dhe të jashtme
- Nuk këshillohet të përdoret mbi suporte druri, gipsi, metalike apo të lyera me bojra të ndryshme më parë.

■ Përgatitja e bazamentit

- Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C ,
- Bazamentet duhet të jenë të fortë, të thatë, të pastër dhe të niveluar. Në rastet e suporteve të betonit, apo dhe polisterolit, këshillohet që bazamenti të paratrajtohet me astarin e përshtatshëm.
- Shtimi i elementëve të tjera duhet të pajiset me një rrjetë xhami të vendosur në pjesën sipërfaqësore të llaçit. Fugat midis tullave duhet të mbyllen mirë dhe çarje apo dëmtime të mundshme në muraturë duhen riparuar, të paktën 48 orë para
- Për të respektuar drejtimin (piombaturën) e mureve këshillohet përdorimi i paraspigolave dhe drejtuesave.
- Llaçi i freskët duhet mbrojtur nga ngricat dhe tharja e shpejtë.
- Të ajrosen mjediset pas aplikimit deri në tharje të plotë, duke evituar luhatjet e mëdha të temperaturës. Aplikimi në prezencë të erës së fortë mund të provokojë formimin e

plasaritjeve dhe “djegieve” të llaçit, ndaj duhen marrë masat e nevojshme. Nuk duhet të aplikohet në prani të ngricave apo kur priten ngrica në 24 orët pasuese.

■ Udhëzime mbi aplikimin

- Materiali i thatë përziejhet me ujë të pastër në sasinë 5.75-6.25 L/thes. Përziejhet në makineri (pompë), ose me përzierës mekanik, derisa të arrihet një masë homogjene.
- Në rastet kur muratura është e punuar shumë mirë llaçi mbushës webermur LM 13 aplikohet me pompë suvatimi dhe në një shtresë të vetme me spesor maksimal 10-15 mm.
- Për spesorë më të mëdhenj se 15 mm aplikohet në më shumë se një shtresë, me hark kohor prej një ditë mes aplikimeve, duke patur kujdes të ashpërsoshet shtresa e suportit. Shtresa e parë duhet të ketë arritur tharjen e nevojshme për të mbajtur peshën e shtresës së dytë.

■ Veglat

Për miksim: mikser elektrik
Për aplikim: mallë metalike

■ Jetëgjatësia

12 muaj, i magazinuar mbi paletë në zona të thata dhe pa ndikim të drejtpërdrejtë nga kushtet e motit. Duhet mbrojtur nga lagështira.

*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.

webermur LM 13

Llaç Suvatimi

Tabela e të dhënave teknike

Nr.Artikulli		
Lloji i paketimit	thes letre	
Sasi për njësi	25 kg / paketim 1350 kg / paletë	
Ngjyra	gri	
Kokërrzimi		
Konsumi për shtresë 10mm	14-15 Kg/m ²	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese dhe në varësi të karakteristikave të bazamentit dhe teknikës së aplikimit.
Konsumi i ujë	5.5-6.75 l/25kg	
Trashësia e shtresës	5-10 mm	

PERFORMANCA

NR	PARAMETRAT	NJËSIA MATËSE	VLERA MINIMALE	VLERA MAKSIMALE	STANDARTI
I	TREGUESIT FIZIKO MEKANIKË				
1	Masa vëllimore në gjendje të shkrifët	Gr/1	1.350	1.450	SSH EN 1015
2	Imtësia mbi sitën me vrima Φ 1.4 m/m	%	0	1	-
3	Imtësia mbi sitën me vrima Φ 0.18 m/m	%	45	50	-
4	Ujë për llaç normal	%	23	25	-
5	Masa vëllimore e llaçit	Gr/1	1.650	1.750	-
6	Rezistenca në shtypje 28 ditore	MPa	2	4	SSH EN 1015-11... 1999
II	TREGUESIT KIMIK				
1	Lagështira	%	0.13		-
2	Aditivë	%	0.3		-

*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.



SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA sh.p.k
Rr. Budull, Nr.3 • 1039 Ahmetaq
Vore • Shqiperi
www.saint-gobain.com
NIPT : L61822023H